



Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Tryeza për Kapitullin 24: Rëndësia për edukimin e publikut për pastrimin e parave – Forcimi i bashkëpunimit me aktorët jo-shtetërorë

21 maj 2025

Xheko Imperial Hotel

10:00 - 12:30

Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në takim në radhës së Grupit të Punës për Kapitullin 24, në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin European. Tryeza për Kapitullin 24 përbën një hapësirë të rëndësishme, duke mundësuar përfshirjen e aktorëve jo-shtetërorë në procesin e negociatave. Qëllimi i saj nuk është vetëm informimi mbi procesin, por përfshirja aktive e tyre në dhënien e rekomandimeve dhe komenteve mbi kuadrin ligjor dhe politikat e miratuara, si dhe në monitorimin e të gjithë procesit në fazat e tij të ndryshme.

Ky aktivitet synon të informojë aktorët e komunitetit të biznesit dhe shoqërisë civile, si dhe palët e tjera të interesit mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë për edukimin e publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit miratuar në dhjetor 2024 dhe të krijojë mundësi për dhënie rekomandimesh, sugjerimesh me anë të një dialogu të strukturuar mes institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe aktorëve të ndryshëm jo-shtetërorë. Strategjia synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për rreziqet që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit dhe të kontribuojë në krijimin e një shoqërie më të informuar dhe të angazhuar për të luftuar këto fenomene. Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit nuk lidhen vetëm me kuadrin ligjor dhe institucional, por gjithashtu kërkojnë një zbatim të fortë dhe të vazhdueshëm të kërkesave ligjore, si dhe angazhimin aktiv të çdo individi dhe institucioni në shoqëri për të parandaluar këto krime. Në këtë kuadër takime të tilla informuese dhe diskutuese janë me rëndësi për të ndarë informacione, eksperiencë dhe përvojën e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë si sektori privat, shoqëria civile, akademja, media apo ekspertë të fushës.

Vlerë e shtuar e këtij takimi është edhe shkëmbimi i praktikave më të mira me Shtetet Anëtare të Bashkimit European, pasi ekspertë sllovakë do të ndajnë përvojat dhe rekomandimet e tyre praktike mbi pastrimin e parave dhe domosdoshmërinë për informim dhe ndërgjegjësim për të gjithë grupet e interesit.

Presim me kënaqësi angazhimin dhe kontributin tuaj në këtë aktivitet!

Kjo tryezë konsultimi zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit European dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPa) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).





Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Tryeza për Kapitullin 24: Rëndësia për edukimin e publikut për pastrimin e parave – Forcimi i bashkëpunimit me aktorët jo-shtetërorë

21 maj 2025

Xheko Imperial Hotel

10:00 - 12:30

09:30 – 10:00

REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE DHE KAFEJA E MIRËSEARDHJES

10:00 – 10:45

FJALA HAPËSE

- Z. Ervin Koçi**, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës Financiare
- Z. Gledis Gjipali**, Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes Europiane në Shqipëri (EMA)
- Z. Nikolin Jaka**, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

10:45 – 11:10

STRATEGJIA PËR EDUKIMIN E PUBLIKUT PËR RREZIKUN E PASTRIMIT TË PARAVE – OBJEKTIVAT DHE ARRITJET

- Objektivat kryesore të strategjisë për edukimin e publikut – Arritjet dhe sfidat
- Masat e ndërmarra për realizimin e objektivave dhe bashkëpunimi ndërinstitucional për implementimin e strategjisë
- Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të shoqërisë civile, bizneseve dhe institucioneve shtetërore për rritjen e efektivitetit të strategjisë

Z. Agim Muslia, Drejtor i Përputhshmërisë dhe IT, Agjencia e Inteligjencës Financiare

11:10 – 11:40

ROLI I SHOQËRISË CIVILE DHE SEKTORIT PRIVAT NË LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE – PRAKTIKAT MË TË MIRA NGA BE PËR RITJEN E BASHKËPUNIMIT DHE ULJEN E RREZIKUT

- Pastrimi i parave në Sllovaki dhe legjislacioni i Bashkimit Evropian
- Rreziqet kryesore për grupet e ndryshme si sektori privat, OShC, publiku
- Politikat ekzistuese për edukimin kundër pastrimit të parave në Sllovaki/BE- Praktikrat më të mira dhe bashkëpunimi me aktorët jo-shtetërorë

Z. Andrej Leontiev, Avokat dhe ekspert për çështjet e pastrimit të parave, Bashkëthemelues i zyrës së avokatisë TaylorWessing në Bratislavë

11:40 – 12:00

DISKUTIM NDËRVEPRUES ME AKTORË TË SHOQËRISË CIVILE, SEKTORIT PRIVAT DHE ME GRUPE TË TJERA INTERESI

12:00 – 12:30

MBYLLJA E AKTIVITETIT DHE KOKTEJL PËR RRJETËZIM

Kjo tryezë konsultimi zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).

